



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 04.10.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti APK-DPKI-06-945/24, për zyrtarin z. Shkelzen Hoxha, Zyrtar i prokurimit- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) ka filluar trajtimin e këtij rasti pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet në kërkesë (citojmë):

“[...] Po ju drejtohem me këtë ankese për një rast të pastër të konfliktit të interesit që po stimulon korrupsion dhe keqpërdorimin e pozitës zyrtare dhe informatave dhe taksave tona.

Ankesa ka të beje me një rast ku zyrtari publik Shkelzen Hoxha, zyrtar dhe shërbyes civil në Qeverinë e Kosovës paraqitet si ekspert i pavarur për OSHP për lëndet ku në ankohemi kundër Qeverisë së Kosovës respektivisht ministrive përkatëse. I njëjti keqpërdor edhe pozitën zyrtare dhe mjetet tona si dhe kohën dhe orarin e punës dhe Ligjin për shërbyes civil, pasi edhe gjatë orarit të punës që paguhet me taksa tona ai përfiton kundërligjshëm duke u paraqitur edhe si ekspert në OSHP, kur dihet se ekziston konflikt i pastër i interesit dhe përfitime të kundërligjshme.

Rasti ka të beje me një ekspertizë të datës 04.11.2023, me numër 2023/0835, ku edhe pse ankesa ka qenë e drejtuar ndaj Ministrisë së Bujqësisë, Qeveria e Kosovës si person juridik, i gjithë Qeverisë dhe Ministrive përkatëse në gjithë Kosovën. (Bashkangjitur prova-ekspertiza e zyrtarit Shkelzen Hoxha).

Se pari duhet theksuar se kemi të bëjmë me konflikt interesi ku vet eksperti Shkelzen Hoxha, është zyrtar në zyrën e prokurimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ku



sipas ligjit për qeverinë konsiderohet kolegë me zyrtarët e prokurimit të AK, pasi të njëjtit janë zyrtar/punonjës i të njëjtit subjekt, respektivisht e kanë punëdhënësin e njëjtë, Qeverinë e Kosovës. Edhe përkufizim sipas Ligjit Nr.06/L-011 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 3 pika 1.6 e përkufizon se personi juridik konsiderohet si person i afërm me zyrtarin.

Prandaj, zyrtari qeveritar i prezantuar si ekspert i jashtëm, z. Shkelzen Hoxha, del se është i anshëm dhe në konflikt të pastër interesi. Eksperti është në konflikt interesi sipas nenit 2 pika 1.3. e Rregullores së OSHP-së numër 83-20, si dhe nenit 3 paragrafi 4, me nenin 5-Parimet si dhe nenin 11-Parandalimin i konfliktit të interesit. Ekspertiza e tij mund të qojë në vendime të gabueshme të OSHP-së e që mund ti përdorë pastaj për veten si zyrtar kur harton dosje tenderi apo kur është palë në OSHP.

Prandaj i njëjti edhe pse ka ditur që është në konflikt interesi edhe pse ka keqpërdor pozitën zyrtare, kohen dhe orarin e punës që paguhet nga taksat tona, me ekspertizën e vet ka dezorientuar OSHP dhe anëtarin fillestar në këtë Bord që të marr vendime të kundërligjshme duke shkelur kështu nenin 9. Veprimet e ndaluara për zyrtarin, pasi me ekspertizën e tij përfitojnë kundërligjshëm palët tjera dhe vet eksperti por edhe shkel detyrën zyrtare, nenin 11 dhe neni 12, dhe pozita e ashtuquajtur si kinse ekspert i pavarur është në kundërshtim me nenin 10”.

Agjenci për Parandalimin e Korrupsionit konform mandatit dhe kompetencave ligjore që i ka sipas Ligjit Nr.08/-017 për Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetim administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar vetëm pretendimet për konflikt të interesit, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Agjencia përmes shkresës zyrtare DPKI-06-945/24, e ka njoftuar zyrtarin e z. Shkelzen Hoxha, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtura një takim në zyrat e Agjencisë, me ç’ rast zyrtari në fjalë është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit dhe me faktet që posedon Agjencia, sa i përket pretendimeve të ngritura për konflikt të interesit.

Me qëllim të sqarimit të plotë të kësaj situate, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ka kërkuar nga z. Hoxha dokumentacion shtesë (*Ndryshim dhe plotësimi i Aktit të Emërimit, nga pozita zyrtar për të Drejtat e Njeriut në Komuna në Divizionin për Avancimin e të Drejtave të Njeriut në Komuna, në kuadër të Departamentit për Përformacë dhe Transparencë Komunale, transferohet në pozitën zyrtar për blerje me vlerë të madhe dhe të mesëm në Divizionin e Prokurimit, dt. 01.06.2014, Konkurs për ekspert të jashtëm të prokurimit dhe ekspert teknike, Kontratë për ofrimin e shërbimeve profesionale Nr. 978/22, si dhe Autorizimet e OSHP-së, në cilësinë e ekspertit shqyrtues për shqyrtim të ankesave të OE).*

Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit në dispozicion, rezulton se z. Hoxha ushtron pozitën zyrtar për blerje me vlerë të madhe dhe të mesme në Divizionin e Prokurimit në Ministrinë e Administrimit të Pushteti Lokal, dhe njëkohësisht është i angazhuar si Ekspert i Jashtëm Profesional i Prokurimit në OSIIP, sipas kontratës për ofrimin e shërbimeve profesionale Nr.978/22, të datës 25.10.2022, me OSHP-në.

WAT
KOSOVA
2022

Pozitën të cilën e ushtron aktualisht z. Shekelzen Hoxha, si zyrtar për blerje me vlerë të madhe dhe të mesme në Divizionin e Prokurimit në MAPL, nuk është pozitë e zyrtarit të lartë në kuptim të nenit 3 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, lidhur me nenin 3 paragrafi 1, të Ligji Nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Pra, si zyrtar për blerje me vlerë të madhe dhe të mesme në Divizionin e Prokurimit në MAPL, z. Hoxha, është person zyrtar në kuptim të nenit 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin duhet kuptuar se kjo kategori e zyrtarëve nuk kanë të njëjtat kufizime sikurse zyrtarët e lartë të përcaktuara në nenin 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsioni, konstatoi se ushtrimi i pozitës zyrtar për blerje me vlerë të madhe dhe të mesme në Divizionin e Prokurimit në MAPL, dhe njëkohësisht të qenurit Ekspert i Jashtëm Profesional i Prokurimit, apriori nuk ndalohet me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, megjithatë në rastet ku angazhohet nga OSHP si ekspert i jashtëm profesional i prokurimit, z. Hoxha duhet të ketë parasys, që Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ka përcaktuar disa ndalesa dhe kufizime të cilat duhet të merren parasys në këtë rast.

Kësisoj, dispozita e nenit 11 të LPKI-së përcakton se:

“1. Zyrtarit i ndalohet që të kryejë punë të tjera nëse:

1.1. mund të keqpërdorë informacionin zyrtar për interesa private;

1.2. punët e tilla mund të ndikojnë në paanshmërinë e ushtrimit të detyrës publike dhe cenojnë respektimin e parimeve të konkurrencës së lirë;

1.3. angazhime të tilla mund të dëmtojnë reputacionin e institucionit; [...]”.

Me dispozitat e sipërcituara është e ndaluar dhe rrjedhimisht duhet evituar edhe vet ‘mundësia’ që të keqpërdoret informacioni zyrtar, të ndikohet në paanshmërinë e ushtrimit të detyrës publike, cenohet respektimi i parimeve të konkurrencës së lirë, apo dëmtohet reputacioni i institucionit, pa pasur nevojë që një keqpërdorim, ndikim, cenim apo dëmtim i tillë të ndodhë, për t’u konsideruar shkelje e dispozitave në fjalë.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit me dispozitën e nenit 17 paragrafi 1 ka përcaktuar se:

1. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.

Veç tjerash, me dispozitën e nenit 20, paragrafi 3 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, shprehimisht është përcaktuar se: *“Institucionet në kuadër të akteve të tyre të brendshme, parashohin dhe zbatojnë rregulla të veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit, varësisht fushëveprimit të institucionit përkatës”.*

Me nenin 2, paragrafin I, nën-paragrafin 1.3 [Përkufizimet] të Rregullores Nr. 01/2020, e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, është përcaktuar se:

Konflikti i Interesit - është situata kur Kryetari apo anëtarët e OSHP-së, një ekspert shqyrtues i OSHP-së, ekspert profesional ose një ekspert i jashtëm, kanë interes privat i cili mund të ndikoj në vendimmarrjen në lëndët që janë objekt i trajtimit në OSHP, dhe mund të rrezikojë interesin publik dhe punën e OSHP-së.

Dispozitat vijuese të nenit 11 të Rregullores Nr.01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, përcaktojnë se:

“1. Kryetari i OSHP-së, Anëtarët e Panelit Shqyrtues, Ekspert Shqyrtues të OSHP-së apo ndonjë staf tjetër i OSHP-së, ose një ekspert apo këshilltar i pavarur, ose ndonjë palë tjetër e tretë, nuk do të jetë i përfshirë në shqyrtimin e një rasti, nëse ai/ajo përballlet me një konflikt të interesit të vendosur nga dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksioneve publike, apo legjislacionit tjetër të zbatueshëm në Kosovë.”

“4. Secili Anëtar i Panelit Shqyrtues, Ekspert Shqyrtues, ekspert ose këshilltar i pavarur do të nënshkruaj një deklaratë për parandalimin e konfliktit të interesit në momentin e përfshirjes në një rast në një konflikt të interesit, dhe të njoftoj personat kompetent. Për qëllim të këtij neni, OSHP-ja do të përgatisë një model të deklaratës së tillë. Deklarata do të jepet nën përgjegjësi administrative dhe penale.”

II. Agjencia vendosi si në pikën III. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë”,* si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”*

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll BULESHKAI
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit